



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA THEMELORE MITROVICË**

---

Numri i lëndës: 2019:257675

Datë: 22.02.2024

Numri i dokumentit: 05360020

**CP.nr.792/2020**

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-Departamenti i Përgjithshëm** me gjyqtarin individual Genc Hasani dhe me bashkëpunëtoren profesionale Valbona Tahiri, në lëndën përbarimore të kreditorit S. S. nga M. te cilin e përfaqëson sipas autorizimit Avokat Faik Jashari nga Mitrovica, kundër debitorit Ndërmarrja “T.” sh.a. me seli ne Mitrovice, lidhur me pagesën e borxhit ne baze te dokumentit përbarimor - Aktgjykimi C.nr. 1085/2019, te datës 07.10.2020, i plotfuqishëm me dt. 06.11.2020, të lejuar me aktvendimin për përbarim CP 792/20, te datës 14.12.2020, jashtë seance gjyqësore, me datën 22.02.2024 morri këtë:

**A K T V E N D I M**

**PËRFUNDOHET** procedura përbarimore e udhëhequr sipas shenjës CP 792/20, te datës 14.12.2020, e iniciuar nga kreditori S. S. nga M., ndaj debitorit Sh. a “T.”, për shkak të pagesës së tërësishme të borxhit nga debitori.

**A r s y e t i m**

Kreditori i përbarimit S. S. nga M., , përmes te autorizuarit te tij avokat Faik Jashari me seli ne Mitrovice, kane paraqitur propozim për përbarim në bazë të dokumentit përbarimor - Aktgjykimi C.nr. 1085/2019, te datës 07.10.2020, i plotfuqishëm me datën 14.12.2020.

Gjykata Themelore në Mitrovicë, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit të përbarimit, me aktvendimin CP 792/20, te datës 14.12.2020, ka lejuar përbarimin ndaj debitorit Ndërmarrja “T.” Sh. a. –me seli ne M.

Pasi aktvendimi për ekzekutim CP 792/20, te datës 14.12.2020, është bere i ekzekutueshëm, i autorizuari i kreditorit Faik Jashari avokat nga Mitrovica me parashtrësën e dt. ..., ka njoftuar gjykatën se debitori i përbarimit e ka përmbushur në tërësi borxhin.

Andaj, borxhi i kërkuar sipas propozimit për përbarim është përmbushur në tërësi, pasi që debitori ka përmbushur në tërësi obligimin ndaj kreditorit të përbarimit, gjykata duke u bazuar në nenin 66 paragrafi 4 të LPP-së, në të cilin parashihet se *“Pas përmbushjes se kredisë*

*se kreditorit nxirret vendimi për përfundimin e procedurës përmbartimore”, vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi.*

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**  
**Departamenti i Përgjithshëm**  
**CP.nr.792/2020 më datë 22.02.2024**

Gjyqtari  
Genc Hasani

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa brenda afatit 7 ditorë nga dita e pranimit të të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Mitrovicë.